As per order in KSC-BC-2020-07/F00001, this filing is cross filed as:
~~STRICTLY CONFIDENTIAL & EX PARTE~~
PUBLIC
Date original: 24/09/2020 01:11:00
Date translation: 12/10/2020 09:00:00

KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Pursuant to instruction of the Single Judge KSC-BC-2020-07/CRSPD3 of 9 October 2020, the document is reclassified as PUBLIC.

Numri:	**KSC-BC-2018-01**
Vendosi:	**Gjykatësi i vetëm**
	Gjykatës Nikola Giju
Administratore:	Dr. Fidelma Donlon
Data:	24 shtator 2020
Gjuha:	Anglishte
Klasifikimi:	**Rreptësisht konfidencial dhe *ex parte***

Vendim mbi kërkesën për lëshimin e fletarrestimeve dhe urdhrave për transferim

---

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

As per order in KSC-BC-2020-07/F00001, this filing is cross filed as: ~~STRICTLY CONFIDENTIAL & EX PARTE~~ PUBLIC Date original: 24/09/2020 01:11:00
Date translation: 12/10/2020 09:00:00
Pursuant to instruction of the Single Judge KSC-BC-2020-07/CRSPD3 of 9 October 2020, the document is reclassified as PUBLIC.

GJYKATËSI I VETËM[1] ka marrë në shqyrtim kërkesën rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* të Prokurorit të Specializuar me titull "Kërkesë urgjente për lëshimin e fletarrestimeve dhe urdhrave në lidhje me to" ("kërkesa"), parashtruar më 22 shtator 2020,[2] dhe lëshon vendimin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU

1. Më 7 shtator 2020, Organizata e Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("OVL-UÇK") mbajti një konferencë për shtyp në të cilën njoftoi se kishte marrë një paketë me dokumente që pretendohet se janë në lidhje me Task Forcën Hetimore Speciale ("TFHS") dhe/ose Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("ZPS"), e cila përmbante kërkesa për bashkëpunim dhe informacion për dëshmitarë.[3] OVL-UÇK-ja u shpërndau kopje të këtyre dokumenteve përfaqësuesve të mediave.[4] Të njëjtën ditë, gjykatësi i vetëm autorizoi sekuestrimin e këtyre dokumenteve dhe ndaloi kopjimin dhe shpërndarjen e tyre dhe të përmbajtjes së tyre.[5] Në bazë të urdhrit të gjykatësit të vetëm, më 8 shtator 2020 ZPS-ja sekuestroi dokumentet nga OVL-UÇK-ja.[6]

2. Më 16 shtator 2020, OVL-UÇK-ja mbajti një konferencë të dytë për shtyp në të cilën njoftoi se kishte marrë një paketë të dytë me dokumente në lidhje me TFHS-në dhe/ose ZPS-në, e cila pretendohej se përmbante deklarata dëshmitarësh dhe prova të

---

[1] KSCPR-2018, F00004, Kryetarja, *Vendim për caktimin e gjykatësit të vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, f. 5.
[2] KSC-BC-2018-01, F00125, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë urgjente për lëshimin e fletarrestimeve dhe për urdhra në lidhje me to*, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat 1-2 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, 22 shtator 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Një parashtrim plotësues lidhur me Kërkesën u dorëzua më 23 shtator 2020, KSC-BC-2018-01, F00126, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorit dhe kërkesa të tjera në lidhje me të* ("Njoftimi"), rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, 23 shtator 2020, me shtojcën 1 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.
[3] Kërkesa, para. 6; Shtojca 1 e Kërkesës, f. 4-5.
[4] Kërkesa, para. 6; KSC-BC-2018-01, F00124,Prokurori i Specializuar, *Raport i Prokurorisë në bazë të vendimit KSC-BC-2018/F00121*, 21 shtator 2020, para. 4; me shtojcën 1 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* ("Raport për Sekuestrimin").
[5] KSC-BC-2018-01, F00121, Gjykatësi i vetëm, *Vendim për autorizimin e sekuestrimit* ("Urdhri i Parë"), 7 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 22.
[6] *Shih* Raport për sekuestrimin.

bashkëpunimit me autoritetet serbe.[7] OVL-UÇK-ja i lejoi përfaqësuesit e mediave që të merrnin kopje të këtyre dokumenteve.[8]

3. Më 17 shtator 2020, gjykatësi i vetëm autorizoi sekuestrimin e paketës së dytë me dokumente dhe ndaloi kopjimin, regjistrimin ose shpërndarjen e këtyre dokumenteve apo të përmbajtjes së tyre.[9] Të njëjtën ditë, ZPS-ja sekuestroi paketën e dytë me dokumente.[10]

4. Më 22 shtator 2020, OVL-UÇK-ja mbajti një konferencë të tretë për shtyp në të cilën njoftoi se kishte marrë edhe një paketë me dokumente që e kishin burimin nga ZPS-ja.[11] Përfaqësuesve të mediave iu lejua qasje në këto dokumente.[12] Në pasditen e 22 shtatorit 2020, ZPS-ja i mori këto dokumente pas nxjerrjes së urdhrit për dorëzimin e tyre.[13]

II. PARASHTRIMET

5. ZPS-ja ndër të tjera kërkon arrestimin dhe transferimin e Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt (përkatësisht "z. Gucati" dhe "z. Haradinaj", bashkërisht "të dyshuarit").[14] ZPS-ja argumenton se janë përmbushur kushtet e nenit 41(6) të Ligjit për këtë qëllim.[15] ZPS-ja pretendon se ekziston dyshim i bazuar se të dyshuarit kanë kryer vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.[16] ZPS-ja pretendon gjithashtu se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se të dyshuarit (i) mund të arratisen;[17]

---

[7] Kërkesa, para. 7; Shtojca 1 e Kërkesës, f. 6-7.
[8] Kërkesa, para. 7; Shtojca 1 e Kërkesës, f. 9.
[9] KSC-BC-2018-01, F00123, Gjykatësi i vetëm, *Vendim për autorizimin e sekuestrimit* ("Urdhri i Dytë"), 17 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 22.
[10] Kërkesa, para. 8.
[11] Kërkesa, para. 9; Shtojca 1 e Kërkesës, f. 12-13.
[12] Kërkesa, para. 9; Shtojca 1 e Kërkesës, f. 14.
[13] Kërkesa, para. 9, Njoftimi, para 4.
[14] Kërkesa, para. 1, 35(a).
[15] Kërkesa, para. 11.
[16] Kërkesa, para. 12-17.
[17] Kërkesa, para. 18-20.

(ii) mund të pengojnë ecurinë e procedimit penal;[18] dhe (iii) mund të përsërisin veprën penale ose të kryejnë vepër penale tjetër.[19]

6. ZPS-ja kërkon gjithashtu që fletarrestimi t'i transmetohet ZPS-së dhe të zbatohet prej saj, në bashkëpunim me Administratoren.[20] Në kuadër të zbatimit të fletarrestimit, ZPS-ja kërkon autorizim që fletarrestimin ta bëjë të ditur për aq sa është e nevojshme për zbatimin e tij.[21]

7. Në lidhje me transferimin e të dyshuarve, ZPS-ja kërkon që gjykatësi i vetëm të urdhërojë transferimin e tyre në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në shtetin pritës, në përputhje me rregullën 50(1)-(2) të Rregullores.[22]

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Në bazë të nenit 39(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), me kërkesë të Prokurorit të Specializuar, gjykatësi i procedurës paraprake mund të lëshojë urdhra dhe fletarrestime nëse kjo është e nevojshme për kryerjen e hetimit dhe përgatitjen e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë.

9. Sipas neneve 387, 388, dhe 392 të Kodit Penal të Kosovës të 2019, nr. 06/L-074 ("KPK"),[23] dhe në bazë të nenit 15(2) të Ligjit, Dhomat e Specializuara kanë juridiksion mbi veprat penale të frikësimit gjatë procedimit penal, hakmarrjes, dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës. Neni 387 i KPK-së në pjesët përkatëse të tij përcakton se kushdo që përdor forcë apo kërcënim të rëndë, ose çfarëdo mënyre tjetër detyrimi për të nxitur një person tjetër të mos japë deklaratë ose të japë deklaratë të rreme, ose të mos i japë informacion të vërtetë policisë, prokurorit apo gjykatësit kur informacione

[18] Kërkesa, para. 21-23.
[19] Kërkesa, para. 24-25.
[20] Kërkesa, para. 31.
[21] Kërkesa, para. 33.
[22] Kërkesa, para. 26.
[23] Këto nene ishin numërtuar me 395, 396, dhe 400 në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012, nr. 04/L-082.

të tilla lidhen me pengimin e procedimit penal, dënohet me gjobë deri në njëqind e njëzet e pesëmijë (125.000) Euro dhe me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet. Neni 388(1) i KPK-së në pjesët përkatëse të tij përcakton se kushdo që ndërmerr një veprim të dëmshëm për cilindo person me synimin e hakmarrjes për shkak të dhënies së informacionit të vërtetë policisë, hetuesit të autorizuar, prokurorit apo gjykatësit lidhur me kryerjen ose kryerjen e mundshme të veprës penale, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet. Neni 392(1) dhe (2) i KPK-së në pjesët përkatëse të tij përcakton se kushdo që pa autorizim zbulon (i) informacion të nxjerrë në një procedurë zyrtare, i cili sipas ligjit nuk duhet të zbulohet apo është shpallur i fshehtë me vendim të gjykatës apo të autoritetit kompetent; ose (ii) informacion për identitetin apo të dhëna personale të një personi të mbrojtur në procedurë penale apo të përfshirë në një program të veçantë për mbrojtje, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit, ose me burgim deri në tre (3) vjet.

10. Sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit, para se të mund të lëshohet një fletarrestim, ZPS-ja duhet së pari të demonstrojë se ekziston dyshim i bazuar se personi përkatës ka kryer vepër penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara. Së dyti, ZPS-ja duhet të provojë se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se ekziston së paku njëra prej tri arsyeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit, përkatësisht se personi në fjalë (i) mund të arratiset; (ii) do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat, ose do të pengojë ecurinë e procedimit penal nëpërmjet ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat apo bashkëkryesit; ose (iii) do të përsërisë veprën penale, do të çojë deri në fund kryerjen e një vepre penale të tentuar apo do të kryejë një vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë. Së fundi, sipas nenit 41(1), (4), dhe (5) të Ligjit, lëshimi i fletarrestimit duhet të jetë në përputhje me të drejtat themelore të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës, dhe personi përkatës duhet të informohet për të drejtat që gëzon në bazë të Ligjit, në mënyrë që t'i ushtrojë këto të drejta para gjykatësit të Dhomave të Specializuara.

11. Në përputhje me rregullën 53(2) të Rregullores, fletarrestimi përmban informacionin në vijim: (i) emrin dhe mbiemrin e personit dhe të dhëna të tjera identifikuese; (ii) veprat penale konkrete mbi bazën e të cilave kërkohet arrestimi i personit; (iii) përshkrim të shkurtër të fakteve të cilat pretendohet se përbëjnë këto vepra penale; dhe (iv) nëse është e zbatueshme, objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në të cilin personi do të transferohet. Rregulla 53(3) e Rregullores përcakton se fletarrestimi mbetet në fuqi deri në një urdhër tjetër të panelit.

12. Sipas rregullës 50(1) të Rregullores, në rast të lëshimit të një fletarrestimi, paneli u drejton autoriteteve kompetente një urdhër për transferimin pa vonesë të personit në Dhomat e Specializuara, dhe në të mund të përfshijë kushtet e transferimit dhe të paraburgimit të mëpasshëm, pas këshillimeve me Administratorin.

13. Në bazë të nenit 35(3) të Ligjit, policia në kuadër të ZPS-së ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që ka policia e Kosovës në bazë të legjislacionit të Kosovës.

14. Në përputhje me rregullën 55(4) të Rregullores, pasi të jetë informuar për arrestimin nga autoritetet kompetente, Administratori bën përgatitjet e nevojshme për transferimin pa vonesë të personit të arrestuar në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, në bashkëpunim me autoritetet kompetente dhe me shtetin pritës.

15. Sipas nenit 41(7) të Ligjit, personat që janë objekt i fletarrestimeve mund të paraburgosen në objektin e paraburgimit të mbikëqyrur nga Dhomat e Specializuara dhe të administruar nga Zyra Administrative në afërsi të selisë së Dhomave të Specializuara në shtetin pritës, në qoftë se proceset gjyqësore janë zhvendosur në shtetin pritës.

IV. DISKUTIM

A. JURIDIKSIONI

16. Në kërkesën e vet, ZPS-ja kërkon lëshimin e një fletarrestimi dhe urdhri të transferimit për të dyshuarit, që të dy shtetas të Kosovës, për vepra penale të pretenduara në bazë të neneve 387, 388, dhe 392 të KPK-së.

17. Në bazë të informacionit të paraqitur nga Prokuroria dhe pa paragjykuar vendimet e ardhshme për këtë çështje, gjykatësi i vetëm konstaton se Dhomat e Specializuara kanë juridiksion *ratione personae* mbi të dyshuarit, të cilët besohet se janë shtetas të Kosovës, në përputhje me nenin 9(2) të Ligjit. Dhomat e Specializuara kanë gjithashtu juridiksion *ratione materiae and ratione temporis*[24] duke qenë se veprat penale të pretenduara përfshihen në nenet 6(2) dhe 15(2) të Ligjit dhe pretendohet se janë kryer në kontekstin e hetimeve të ZPS-së dhe rrjedhimisht kanë lidhje me procedurat zyrtare të Dhomave të Specializuara.

B. KUSHTET E NENIT 41(6) TË LIGJIT

18. Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të 2012, Ligji nr. 04/L-123 ("KPPK"), standardi i provës për "dyshimin e bazuar" përkufizohet si "njohuri për informacionin që do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur, po ndodh ose ka mundësi të konsiderueshme që do të ndodhë dhe se personi në fjalë ka më shumë gjasa që të ketë kryer veprën penale se sa që të mos e ketë kryer atë".[25]

---

[24] Duke qenë se sipas neneve 6(2) dhe 15(2) të Ligjit veprat penale të përmendura duhet të jenë në lidhje me procedura zyrtare, juridiksioni kohor për këto vepra penale shtrihet përtej periudhës kohore të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit.

[25] *Shih gjithashtu* nenin 5(1)(c) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, sikurse është interpretuar prej Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Fox, Campbell and Hartley v. United Kingdom*, nr. 12244/86; 12245/86; 12383/86, Aktgjykim, 30 gusht 1990, vëll. 182, Seria A, f. 16, para. 32; *K.-F. v. Germany*, nr. 144/1996/765/962, Aktgjykim, 27 nëntor 1997, Raporte 1997-VII, para. 57; *Labita v. Italy*, nr. 26772/95, Aktgjykim, 6 prill 2000, para. 155; *Berktay v. Turkey*, nr. 22493/93, Aktgjykim, 1 mars 2001, para. 199; *O'Hara v. United Kingdom*, nr. 37555/97, Aktgjykim, 16 tetor 2001, para. 34.

19. Nëse ky standard është përmbushur, arsyet mbi bazën e të cilave gjykatësi i vetëm mund t'i heqë lirinë një personi duhet të jenë të artikulueshme.[26] Në këtë kontekst, gjykatësi i vetëm rikujton se për përcaktimin e ekzistencës së cilitdo prej rreziqeve të parapara në nenin 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit që e bën të domosdoshëm arrestimin e personit, nevojitet të vlerësohet mundësia e këtyre rreziqeve përkundrejt pashmangshmërisë së materializimit të tyre.[27]

1. Veprat penale që pretendohet se janë kryer

(a) Frikësimi

20. Në kërkesën e vet, ZPS-ja parashtron se ekziston dyshim i bazuar se të dyshuarit kanë kryer veprën penale të frikësimit gjatë procedimit penal (i) duke shpërndarë dokumente dhe informacion konfidencial dhe jopublik, përfshirë emrat, të dhënat personale dhe dëshmitë e dëshmitarëve (të mundshëm) dhe (ii) duke bërë deklarata që demonstrojnë mospërfillje për rreziqet e mundshme për këta dëshmitarë.[28]

21. Gjykatësi i vetëm vë në dukje se të dyshuarit mbajtën tri konferenca për shtyp për të bërë publik faktin që kishin në posedim dokumente konfidenciale dhe jopublike në lidhje me punën e ZPS-së.[29] Duket se të dyshuarit ua shpërndanë dokumentet shtypit, ose ndryshe ua vunë në dispozicion mediave.[30] Z. Haradinaj duket gjithashtu se ka përmendur me emër disa dëshmitarë (të mundshëm) dhe ka dhënë informacion për vendin e banimit dhe të dhëna të tjera personale të tyre.[31] Publikimi i këtij informacioni konfidencial u bë në kuadër të përligjjes së pikëpamjes së tyre se Dhomat e Specializuara "kanë rënë pre edhe karrem i vetë Serbisë [dhe po vazhdojnë] të

---

[26] Neni 19.1.9 i KPPK-së.
[27] *Ngjashëm*, ICC/GJPN, *Prosecutor v. Bemba Gombo et al./Prokurori k. Bemba Gombos dhe të tjerëve*, ICC-01/05-01/13-558, Appeals Chamber/Dhoma e Apelit, *Judgment on the appeal of Mr Aimé Kilolo Musamba against the decision of Pre-Trial Chamber II of 14 March 2014 entitled "Decision on the 'Demande de mise en liberté provisoire de Maître Aimé Kilolo Musamba'"*,11 korrik 2014, para. 107.
[28] Kërkesa, para. 13-14.
[29] Kërkesa, para. 6-10; Shtojca 1e Kërkesës, f. 1-4, 6-7, 12-13.
[30] Kërkesa, para. 6, 7, 9; Shtojca 1 e Kërkesës, f. 4-5, 9, 14.
[31] Shtojca 1 e Kërkesës, f. 2-4.

dëmtojnë Kosovën pikërisht me aparatin shtetëror të Millosheviqit".[32] Për më tepër, kur u pyet për sigurinë e dëshmitarëve, z. Haradinaj u përgjigj se "si mund të garantohet siguria e dëshmitarëve kur emrat e tyre mund t'i lexojë çdokush. […] Mua nuk më intereson për dëshmitarët e gjykatës së Hagës. Sa për mua, unë do t'i kisha publikuar të dhënat e të gjithë dëshmitarëve të kësaj gjykate."[33] Dëshmitarë të tillë më tutje u quajtën "njerëz kundër kombit dhe njerëz që nuk e duan Kosovën".[34] Prania e z. Gucati në konferencat për shtyp dhe mosndërhyrja e tij demonstrojnë pajtimin e tij me deklaratat e z. Haradinaj.

22. Duke marrë parasysh shpërndarjen e informacionit konfidencial dhe jopublik për dëshmitarë të mundshëm me një mospërfillje të hapur ndaj rreziqeve të mundshme për ta dhe një kërcënim të nënkuptuar ndaj sigurisë së tyre, gjykatësi i vetëm konstaton se të dyshuarit shpërndanë qëllimisht informacion konfidencial dhe jopublik si kërcënim i rëndë ose një mënyrë tjetër e detyrimit për të nxitur një person ose persona të tjerë që të mos japin deklarata apo të japin deklarata të rreme, ose të mos i japin informacion të vërtetë ZPS-së dhe/ose Dhomave të Specializuara. Rrjedhimisht, gjykatësi i vetëm konstaton se ekziston dyshim i bazuar se të dyshuarit u orvatën[35] të kryejnë veprën penale të frikësimit në bazë të nenit 387 të KPK-së.

(b) Hakmarrja

23. Në kërkesën e vet, ZPS-ja parashtron se ekziston dyshim i bazuar se të dyshuarit kanë ndërmarrë veprime të dëmshme kundër dëshmitarëve (të mundshëm) duke shpërndarë informacion konfidencial dhe jopublik në lidhje me ta me synimin e

[32] Shtojca 1 e Kërkesës, f. 1.
[33] Shtojca 1 e Kërkesës, f. 5.
[34] Shtojca 1 e Kërkesës, f. 9.
[35] Theksohet gjithashtu se në nenin 28(2) të KPK-së tentativa për të kryer vepër penale konsiderohet vepër penale, për të cilën mund të shqiptohet dënim me tre ose më shumë vjet burgim. Neni 387 i KPK-së përcakton se frikësimi gjatë procedimit penal është i ndëshkueshëm me gjobë deri në njëqind e njëzet e pesëmijë (125.000) euro dhe me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet. Rrjedhimisht, vepra penale e tentativës për të kryer frikësim gjatë procedimit penal njihet në nenet 28(2) dhe 387 të KPK-së.

hakmarrjes kundër personave të tillë për shkak që i kanë dhënë informacion TFHS-së dhe/ose ZPS-së lidhur me kryerjen ose kryerjen e mundshme të veprave penale.[36]

24. Gjykatësi i vetëm gjykon se shpërndarja prej të dyshuarve e informacionit konfidencial dhe jopublik,[37] veçanërisht e emrave dhe të dhënave personale të dëshmitarëve (të mundshëm),[38] përbën vepër të dëmshme duke qenë se i ekspozon dëshmitarët e tillë ndaj kërcënimeve të mundshme ndaj sigurisë së tyre. Të dyshuarit i njohën dhe pranuan shprehimisht këto rreziqe.[39] Për më tepër, synimi i hakmarrjes për dhënien e informacionit të vërtetë në lidhje me kryerjen e pretenduar të veprave penale gjatë viteve 1998/1999, dëshmohet nga kërcënimi për publikimin e të dhënave të të gjithë dëshmitarëve të Dhomave të Specializuara, pavarësisht rreziqeve të njohura ndaj personave të tillë,[40] si edhe nga sugjerimi i të dyshuarve se ata që i kanë dhënë deklarata TFHS-së dhe/ose ZPS-së janë "njerëz kundër kombit dhe njerëz që nuk e duan Kosovën."[41] Prania e z. Gucati në konferencat për shtyp dhe mosndërhyrja e tij demonstrojnë pajtimin e tij me deklaratat e z. Haradinaj. Rrjedhimisht, gjykatësi i vetëm konstaton se ekziston dyshim i bazuar se të dyshuarit kanë kryer veprën penale të hakmarrjes në bazë të nenit 388 të KPK-së.

(c) Shkelja e fshehtësisë së procedurës

25. Në kërkesën e vet, ZPS-ja parashtron se ekziston dyshim i bazuar se është kryer shkelje e nenit 392 të KPK-së përmes shpërndarjes së dokumenteve konfidenciale dhe jopublike që burojnë nga hetimet penale të TFHS-së dhe/ose ZPS-së.[42]

---

[36] Kërkesa, para. 15.
[37] Kërkesa, para. 6, 7, 9; Shtojca 1 e Kërkesës, f. 4-5, 9, 14.
[38] Shtojca 1 e Kërkesës, f. 2-4.
[39] Shtojca 1 e Kërkesës, f. 5.
[40] Shtojca 1 e Kërkesës, f. 5.
[41] Shtojca 1 e Kërkesës, f. 9.
[42] Kërkesa, para. 16.

26. Gjykatësi i vetëm vë në dukje se të dyshuarit kanë zbuluar informacion dhe dokumente[43] nga hetimet e TFHS-së dhe ZPS-së.[44] Gjykatësi i vetëm ka pranuar që ky informacion është konfidencial dhe jopublik dhe ka paralajmëruar, veçanërisht z. Gucati, dhe OVL-UÇK-në në përgjithësi, të paktën dy herë, që të mos shpërndajnë informacion të tillë.[45] Deklaratat e të dyshuarve gjatë konferencave për shtyp demonstrojnë se ata janë të vetëdijshëm për natyrën konfidenciale të dokumenteve që ua dhanë mediave.[46] Rrjedhimisht, gjykatësi i vetëm konstaton se ekziston dyshim i bazuar se të dyshuarit kryen veprën penale të shkeljes së fshehtësisë së procedurës në bazë të nenit 392 të KPK-së.

2. Domosdoshmëria e arrestimit

27. ZPS-ja parashtron se arrestimi i të dyshuarve është i domosdoshëm duke qenë se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se të tre rreziqet e parapara në nenin 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit janë të pranishme.[47]

28. Për sa i përket rrezikut të arratisjes, gjykatësi i procedurës mban parasysh (i) vënien në dijeni të të dyshuarve për veprat penale të pretenduara të paraqitura në fletarrestimin që do të dorëzohet, si dhe për dënimet e mundshme;[48] (ii) qasjen e të dyshuarve në fonde të konsiderueshme në cilësinë e tyre si kryetar dhe nënkryetar të OVL-UÇK-së[49] si dhe (iii) rrjetin e gjerë të përkrahësve që përfshin persona me ekspertizë në lëmin e sigurisë, policisë dhe inteligjencës;[50] dhe (iv) mundësinë e të

[43] Kërkesa, para. 6, 7, 9; Shtojca 1 e Kërkesës, f. 2-5, 9, 14.
[44] Hetimet mund të konsiderohen "procedura zyrtare" sipas nenit 376 të KPK-së dhe neneve 6(2) dhe 101 të KPPK-së.
[45] Urdhri i Parë, para. 22; Urdhri i Dytë, para. 22.
[46] Shtojca 1 e Kërkesës, f. 12-13, 17
[47] Kërkesa, para. 11.
[48] Kërkesa, para. 18. *Shih më lart*, para. 20-26.
[49] Kërkesa, para. 19.
[50] Kërkesa, para. 19.

dyshuarve për të udhëtuar në mënyrë të ligjshme dhe të paligjshme në juridiksione të cilat nuk kanë detyrimin e transferimit të tyre në Dhomat Specializuara.[51]

29. Për sa i përket pengimit të procesit, gjykatësi i vetëm mban parasysh që të dyshuarit kanë shpërndarë informacion dhe dokumente konfidenciale dhe jopublike që burojnë nga hetimet e TFHS-së dhe/ose ZPS-së.[52] Të dyshuarit gjithashtu kanë bërë me dije se do të vazhdojnë të nxjerrin informacion konfidencial dhe jopublik[53] dhe i kanë inkurajuar përfaqësuesit e mediave të bëjnë të njëjtën gjë.[54] Informacione të tilla janë bërë publike me një mospërfillje të hapur ndaj rrezikut për sigurinë e dëshmitarëve të mundshëm[55] dhe me synimin e delegjitimimit të një gjykate që ata nuk e njohin.[56] Për këto arsye, gjykatësi i vetëm konstaton se të dyshuarit kanë motivin, mjetet dhe mundësinë për të penguar ecurinë e procedimit penal.

30. Në lidhje me mundësinë e kryerjes së veprave penale të tjera, gjykatësi i vetëm thekson se të dyshuarit kanë bërë të qartë synimin për të vazhduar me nxjerrjen publike të informacionit konfidencial dhe jopublik lidhur me dëshmitarë të mundshëm dhe hetimet e TFHS-së dhe/ose ZPS-së,[57] çka demonstron rrezikun në vijimësi të kërcënimit, frikësimit dhe vënies në rrezik të dëshmitarëve (të mundshëm) përmes nxjerrjeve të ngjashme të informacionit.

31. Për arsyet e lartpërmendura, gjykatësi i vetëm konstaton se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se ekziston rreziku i arratisjes së të dyshuarve, i pengimit prej tyre të ecurisë së procesit, apo i kryerjes së veprave penale të tjera, çka e bën të domosdoshëm arrestimin dhe paraburgimin e tyre në përputhje me nenin 41(6)(b) të Ligjit.

---

[51] Kërkesa, para. 20.
[52] Kërkesa, para. 6, 7, 9; Shtojca 1 e Kërkesës, f. 4-5, 9, 14.
[53] Shtojca 1 e Kërkesës, f. 5; Shtojca 2 e Kërkesës, f. 8.
[54] Shtojca 1 e Kërkesës, f. 9; Shtojca 2 e Kërkesës, f. 7.
[55] Shtojca 1 e Kërkesës, f. 5.
[56] Shtojca 1 e Kërkesës, f. 1, 8; Shtojca 2 e Kërkesës, f. 8.
[57] Shtojca 1 e Kërkesës, f. 5; Shtojca 2 e Kërkesës, f. 8.

C. PËRPUTHSHMËRIA ME TË DREJTAT THEMELORE

32. ZPS-ja parashtron se gjatë zbatimit të fletarrestimit, do të merren masat e nevojshme për mbrojtjen dhe respektimin e duhur të viktimave dhe dëshmitarëve përkatës, si dhe të të drejtave themelore të të dyshuarve.[58] Në qoftë se ZPS-ja zotohet të ndërmarrë masa të tilla, gjykatësi i vetëm gjykon se asgjë në kërkesën e ZPS-së për lëshimin e një fletarrestimi dhe urdhri për transferim nuk është *prima facie* në mospërputhje me të drejtat themelore të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, në pajtim me nenin 41(4) dhe (5) të Ligjit dhe rregullën 55(6) të Rregullores, të dyshuarit duhet të informohen për të gjitha drejtat që u takojnë në bazë të Ligjit posa të paraburgosen dhe ndodhen nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara, me qëllim ushtrimin e këtyre të drejtave para gjykatësit të vetëm sa më shpejtë që të jetë e realizueshme.

D. URDHËR PËR TRANSFERIM NË OBJEKTIN E PARABURGIMIT TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA

33. Duke mbajtur parasysh ndryshimin e vendit të zhvillimit të procesit[59] dhe për arsye të sigurisë dhe të administrimit të duhur të drejtësisë, gjykatësi i vetëm e gjykon të domosdoshme që të dyshuarit të transferohen në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, të administruar nga Administratorja, në shtetin pritës. Në përputhje me nenin 41(7) të Ligjit dhe rregullën 55(4) të Rregullores, Administratorja zbaton urdhrin për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në shtetin pritës dhe bën përgatitjet e nevojshme praktike për transferimin pa vonesë të të dyshuarve.

---

[58] Kërkesa, para. 32.

[59] KSCPR-2018, F00003, Kryetarja, *Vendim mbi kërkesën e Prokurorit të Specializuar për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës në bazë të nenit 3(8)(a) të Ligjit*, 29 maj 2018, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, f. 3. Duke mbajtur parasysh vendimin e përmendur më lart, kërkesa e ZPS-së për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procesit nuk ka më objekt shqyrtimi, shih Kërkesa, para. 4.

E. DORËZIMI DHE ZBATIMI I URDHRAVE

34. Në bazë të nenit 35(3) të Ligjit, policia në kuadër të ZPS-së ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që ka policia e Kosovës në bazë të legjislacionit të Kosovës. Për këtë arsye, ZPS-ja mund të konsiderohet "autoritet kompetent" në kuptim të nenit 49(1) të Rregullores, i aftë për zbatimin dhe dorëzimin e urdhrave të Dhomave të Specializuara, ndër të tjera edhe të fletarrestimeve që i bashkëlidhen këtij vendimi.[60] Në përputhje me rregullën 49(1) të Rregullores, Administratorja transmeton urdhrin për transferim në bashkëpunim me ZPS-në. Sipas rastit dhe nëse është e nevojshme, ZPS-ja mund ta bëjë të ditur fletarrestimin për nevoja të zbatimit të tij.

35. Pas mbërritjes nga Kosova në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, Administratorja i paraqet gjykatësit të vetëm një raport lidhur me arrestimin dhe transferimin e të dyshuarve, duke përfshirë të dhënat dhe informacionin përkatës të marrë nga ZPS-ja.

V. VENDIM

36. Për arsyet e lartpërmendura, gjykatësi i vetëm:

a. **MIRATON** kërkesën për lëshimin e fletarrestimeve (shtojcat 1 dhe 3);

b. **MIRATON** kërkesën për lëshimin e urdhrave për transferim (shtojcat 2 dhe 4);

c. **URDHËRON** ZPS-në t'i dorëzojë dhe zbatojë fletarrestimet e bashkëlidhura në Kosovë;

d. **URDHËRON** ZPS-në të këshillohet me Administratoren lidhur me përgatitjet e nevojshme praktike për dorëzimin dhe zbatimin e

[60] Me njoftimin e Prokurorit të Specializuar për këtë vendim dhe dy shtojcat e tij nëpërmjet sistemit elektronik *Legal Workflow*, transmetimi i dokumenteve përkatëse Prokurorit të Specializuar konsiderohet i kryer, në përputhje me rregullat 49(1) dhe 55(1) të Rregullores.

fletarrestimeve, përfshirë bërjen të ditur të tyre për aq sa është e duhur dhe e domosdoshme për dorëzimin dhe zbatimin e tyre;

e. **URDHËRON** Administratoren të kryejë transferimin e të dyshuarve në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Holandë; dhe

f. **URDHËRON** Administratoren që pas mbërritjes në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të paraqesë raport lidhur me arrestimin dhe transferimin e të dyshuarve, duke përfshirë të dhënat dhe informacionin përkatës të marrë nga ZPS-ja.

/nënshkrim/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i vetëm

E enjte, 24 shtator 2020

Në Hagë, Holandë.